



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 530/5 Prot

Tiranë, më 14.10.2020

**V E N D I M**

Nr.120, datë 14.10.2020

***“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së informacionit të dërguar, në lidhje me egzistencën e një konflikti të vazhdueshëm interesi në administratën e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një informacioni të marrë për ekzistencën e një konflikti interesi në administratën e AZHBR,

**Vërej se:**

Nëpërmjet një informacioni të rregjistruar në datën 09.06.2020 “Njoftim për shkelje të nëpunësit civil \*\*\*\*\*”, si dhe kërkesë për hetim administrativ”, protokolluar me nr. 530 prot., datë 12.06.2020, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka marrë dijeni për një pretendim se nëpunësja \*\*\*\*\*, në periudhën 01.02.2019 - 08.04.2019, në konflikt interesi, krahas pozicionit “Drejtor në Drejtorinë e Financës”, pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, ka mbajtur edhe pozicionin e Administratorit të Shoqërisë Tregtare “Igor Konstruktion”, duke zotëruar 100% të kuotave, veprim ky që vjen në kundërshtim me përcaktimet e neneve 446 e 47 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Njëkohësisht, për sa më sipër është vënë në dijeni edhe Departamenti i Administratës Publike, i cili nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 2468/1 prot., datë 12.06.2020, “Kalim për kompetencë trajtimi”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 530/1 prot., datë 15.06.2020, ka dërguar për kompetencë kërkesën së bashku me dokumentacionin përkatës, për hetim administrativ dhe vlerësim të këtij informacioni.

Në përmbajtjen e informacionit në fjalë, ngrihet pretendimi se nëpunësja \*\*\*\*\* krahas pozicionit “Drejtor në Drejtorinë e Financës”, pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, mban edhe pozicionin e Administratorit të Shoqërisë Tregtare “Igor Konstruksion”, duke zotëruar 100% të kuotave, gjë e cila përbën konflikt të hapur interesi, pasi vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Për vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre pretendimeve, nëpërmjet shkresës me nr.530/2 prot., datë 19.06.2020, “Njoftim për fillimin e verifikimit të informacionit, për konflikt interesi”, Komisioneri, ka vënë në dijeni institucionin Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për fillimin dhe objektin e verifikimit, duke kërkuar për këtë edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e institucionit të AZHBR, me shkresën nr.1639/6, datë 27.11.2019, “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 30/3 prot., datë 09.07.2020, është dërguar dokumentacioni bashkë me sqarimin përkatës në lidhje me problemin e ngritur.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procesi, ka rezultuar e vërtetuar si më poshtë:

Në muajin mars të vitit 2019, punonjësja \*\*\*\*\* e punësuar në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Financës” në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, menjëherë sapo ka dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) kontratën e blerjes së Kuotave të kompanisë së bashkëshortit të saj \*\*\*\*\* dhe vendimin e asamblesë së kompanisë për caktimin e saj si administratore të kompanisë, ka informuar institucionin dhe eprorin e saj në lidhje me sa më sipër, duke kërkuar edhe një vlerësim nëse situata e krijuar përbën shkelje të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Pas konsultimeve të bëra me legjislacionin përkatës që rregullon parandalimin e konfliktit të interesit, në datën 8 Prill 2019, pra brenda një periudhe të shkurtër (më pak se 2-muaj), nëpunësja në fjalë ka bërë shitjen e kuotave të saj dhe dorëzimin e detyrës si administratore e shoqërisë, duke vepruar sipas detyrimit të përcaktuar në nenet 37 dhe 38, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

Njëkohësisht në shkresën e tij institucioni (AZHBR) sqaron se pas verifikimeve të mëvonshme, të bëra në databazën e QKB-së dhe në sistemin e sigurimeve shoqërore nëpërmjet portalit “e-albania”, rezultoi se nëpunësja \*\*\*\*\* nuk rezultoi si

administratore në asnjë subjekt ekonomik privat, duke shënuar në këtë mënyrë përfundimisht, evitimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas konstatimit të gjendjes si më sipër, arrihet në përfundimin se nëpunësja \*\*\*\*\*,  
nuk është në gjendje konflikti i interesit me pozicionin e saj të punës “Drejtor në Drejtorinë e  
Financës” në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, prandaj hetimi administrativ duhet  
të deklarohet i përfunduar dhe çështja të arkivohet.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit  
nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015,  
“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe  
35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.  
17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me  
nr. 530 prot., datë 12.06.2020, në lidhje me egzistencën e një konflikti të  
vazhdueshëm i interesit, në administratën e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural  
dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike dhe AZHBR. Të  
interesuarit e tjerë mund të njihen me përmbajtjen e vendimit në faqen zyrtare të  
KMSHC.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**